

PËRFSHIHUNI NË NJË SUEDI MË TË SIGURT!

Jeni në nevojë! Bëhuni pjesë e sigurimit të një fitoreje zgjedhesh Sociale Demokratike në çfarëdo mënyre që të mundeni. Flisni me miqtë, kolegët dhe fqinjët ose bashkohuni me ne si punëtor i fushatës zgjedhore. Bëhuni anëtar i Partisë Social Demokratike Suedeze.



Na ndiqni në Facebook Instagram Twitter

Dua të bëhem anëtar i Social Demokratëve

Dua të marr lajme nga ju

Emri

Telefoni..... Email

Adresa

Kodi postar dhe qyteti postar

Numri personal i identifikimit

Vizitoni socialdemokraterna.se/bli-medlem
ose plotësoni fletën, futeni në një zarf dhe
na e dërgoni. Dërgojeni në këtë adresë.
Nuk ka nevojë për vulë:

Ne do t'i ruajmë të dhënat tuaja personale. Informacione të mëtejshme gjenden në
socialdemokraterna.se/integritetspolicy

Socialdemokraterna
Svarspost
Kundnummer 110 651 700
110 03 Stockholm

Albanska



Socialdemokraterna

Ky është përkthim i një versioni të thjeshtuar të tekstit original në suedisht. Nëse ka
disa nuanca në kuptimet e versioneve, do të mbizotërojë versioni origjinal në suedisht.

**NJË SHOQËRI
MË E FORTË.
NJË SUEDI MË
E SIGURT.**

VOTONI PËR NJË SHOQËRI MË TË FORTË DHE NJË SUEDI MË TË SIGURT!

E di se çfarë do të thotë siguria për një person. Nga rritja në një institucion kujdesi, nga njerëzit e shumtë të papunë që kam takuar gjatë kohës sime në industri, nga të moshuarit e shumtë që takoj sot si Kryeministër, këtë e di mirë: siguria është gjithmonë e nevojshme nëse duam të ndihemi të lumtur dhe të sigurt.

Sot, ekonomia e Suedisë është e fortë. Nga viti 2014, 300,000 më shumë njerëzit kanë një vend ku të shkojnë. Papunësia e të rinjve është në nivelin më të ulët për 16 vjet. Kemi prezantuar një politikë emigracioni të qëndrueshme dhe kemi ulur varësinë ndaj ndihmave sociale në nivelin më të ulët që në vitin 1981.

Duam ta përdorim këtë pikë të fortë për të implementuar programin më të madh të sigurisë shoqërore në kohët moderne. Synimi ynë është një shoqëri më e fortë. Një shoqëri që ka energjinë të punësojë më shumë mësues dhe infermierë, dhe të sigurohet që të jesh i moshuar nuk do të thotë të jesh i varfër. Kjo ka fuqinë të luftojë krimin pa kompromis. Kjo siguron që kushdo që mund të punojë, të punojë. Kjo është aty për ju kur keni nevojë për ndihmë por gjithashtu krijon kërkesën. Jep nxitjen e nevojshme për t'u përballur me veçimin në rrënjët e tij në mënyrë që Suedia të qëndrojë e bashkuar.

Sidoqoftë, zgjedhja është e juaja. Ka nga ata që preferojnë të shohin zgjidhje të drejtuara më tepër nga tregu në shkollat dhe spitalet tona. Të cilët duan të përdorin paratë tona për të pakësuar edhe njëherë taksat për ata që tashmë kanë humbur, ndërkohë që njerëzit e zakonshëm paguajnë çmimin përmes uljes së ndihmave sociale.

Prandaj, thirrja ime është e thjeshtë: Bashkohuni me ne për një shoqëri më të fortë dhe një Suedi më të sigurt. Votoni për Partinë Social Demokrate më 9 shtator.



Stefan Löfven



PROGRAMI MË I MADH I SIGURISË SHOQËRORE NË KOHËT MODERNE

SIGURI PËRMES MIRËQENIES MË TË FORTË

Ne duam që:

Të punësojmë më shumë staf në shëndetësi. Do të marrim në punë 14,000 më shumë staf në shëndetësi për të lehtësuar ngarkesën mbi personelin, për të pakësuar radhët dhe për të ofruar kujdes më të shpejtë.

Të ndalojmë ndjekjet e fitimeve në sektorin e mirëqenies. Do të prezantojmë një tavan fitimi dhe rregulla për t'u siguruar që paratë e synuara për mirëqenie të shkojnë për mirëqenie. Gjithashtu do të ndalojmë shkollat fetare falas.

Të rritim pensionet. Ata që kanë punuar gjithë jetën e tyre në punë me paga të ulëta do të shohin rritjen e pensioneve të tyre përmes një shtese në pensionin kombëtar, dhe do të marrim hapat finale drejt braktisjes komplet të taksës së padrejtë mbi pensionin.

SIGURI PËRMES VEPRIMEVE TË FORTA KUNDËR KRIMIT

Ne duam që:

Të punësojmë më shumë policë. Do të punësojmë 10,000 më shumë staf policie deri në vitin 2024 me qëllim që të zgjidhim më tepër krime dhe të krijojmë më shumë siguri në rrugët dhe hapësirat tona publike.

Të ndalojmë dhunën kundër grave. Do të luftojmë dhunën e burrave kundër grave, dhunën që lidhet me nderin, prostitucionin dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Të parandalojmë të rinjtë që të mos bien në kriminalitet. Do të krijojmë një politikë që sulmon kriminalitetin në rrënjët e tij duke pakësuar pabarazinë shoqërore dhe duke luftuar padrejtësinë përmes ndërhyrjes në kohë dhe duke ofruar më shumë mundësi për të dalë nga kriminaliteti.

SIGURI PËRMES INTEGRIMIT MË TË SHPEJTË

Ne duam që:

Të sigurohemi që të gjithë të jenë në punë pavarësisht gjinisë ose prejardhjes. Jemi për kushte të mira pune dhe paga të drejta. Përmes investimeve të mëdha në arsim, do të krijojmë mundësi për të gjithë që të punojnë. Njëkohësisht, do ta bëjmë komplet të qartë se rruga për integrimin në shoqërinë suedeze është përmes vetëplotësimit.

Të ndalojmë forcat që na ndajnë. Do të luftojmë të gjitha forcat e militantëve politike dhe ekstremizmit fetar.

Të prezantojmë një kërkesë për gjuhën. Kushdo që nuk është në gjendje të gjejë punë për shkak të pamundësisë për të folur suedisht, duhet të mësojë gjuhën.